MESAZH ME RASTIN E MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1443/2022

AGJËRIMI I NDËRPRERË DHE AGJËRIMI ISLAM

PARAQITJA E VEPRAVE TEK ALLAHU (XH.SH) NË MUAJIN SHABAN

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 20 - Nr. 3 (229), Mars, 2022

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

MUSLIMANËT, SI SHEMBULL
I BASHKËJETESËS PAQËSORE NDËR SHEKUJ

Kur'ani Famëlartë dhe tradita profetike, vendosën rregullat dhe bazat e bashkëjetesës së muslimanëve me jomuslimanët, rregulla që bazohen mbi një të drejtë të shenjtë që është e drejta e fisnikërisë njerëzore!

KORDOVA, ANDALUZI - SPANJË

"RËNDËSIA E STUDIMIT TË TRASHËGIMISË POPULLORE NË KULTURËN ISLAME"

Ditën e shtunë, më 12 mars 2022, Myftinia Shkodër organizoi seminarin e 10-të trajnues me pjesëmarrjen e një grupi imamësh të xhamive të qytetit dhe fshatrave.

Merrnin pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, si dhe i ftuari special, si ligjëruea, Kryeimami i Bashkësisë Islame të Ulqinit, Ali ef. Bardhi.

Tema e këtij seminari ishte: "Rëndësia e studimit të trashëgimisë popullore në kulturën islame"...

(f. 16)

AKTIVITET PËR 7 MARSIN, NDERIM PËR MËSUESIN!

Ditën e hënë, më 7 mars 2022, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën e Miqësisë "Shqipëri-Vende Arabe" organizoi një aktivitet kulturor me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

Krahas pjesëmarrjes së drejtuesve të Myftinisë dhe shoqatës, të pranishëm ishin veteranë të arsimit në Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë, të cilët me punën e tyre të palodhur dhe sakrifica edukuan dhe arsimuan breza të shumtë ndër vite.

Në fjalën e tij të hapjes, teologu Arben Halluni tha...

(f. 15)

MUSLIMANËT, SI SHEMBULL I BASHKËJETESËS PAQËSORE NDËR SHEKUJ

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të nderuar e të dashur vëllezër,

Tema për të cilën jam ngarkuar të flas sonte, para jush, është një hapësirë e gjerë dhe e gjatë, e mbushur me mirësi pa fund, me shembuj dhe pika referimi për mbarë botën, në rrugëtimet e saj drejt konsolidimit të vlerave të paqes, harmonisë dhe bashkëjetesës së njeriut me vëllanë e tij njeri, përtej përkatësive fetare dhe drejtimeve të ndryshme që njeriu zgjedh në jetën e tij.

Kushdo që e shfleton Kur'anin Famëlartë dhe mediton në emërtimet e sureve, si dhe në përmbajtjen e shumë ajeteve, ku përmenden të dërguarit e mëparshëm, me emra dhe detaje, pasuesit e Librave të Shenjtë, me emra dhe detaje, si dhe ku jepen udhëzime drejt ruajtjes së ekuilibrave në shoqëri, bazuar në besimin në Një Zot dhe shfaqjen e drejtësisë, kupton qartë se, Zoti i gjithësisë, ka kërkuar nga njeriu që të jetojë në harmoni me tjetrin, kushdo qoftë ai. Në këtë kontekst, është kërkuar që njeriu të respektojë besimin dhe përzgjedhjen e tjetrit, mos të fyejë e mos të ironizojë fenë e tij dhe simbolet e saj, por jo vetëm. Në Kur'an, urdhërohemi: "Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur".

Në këtë kontekst, Resulullahu (a.s) thoshte: "Shembulli im dhe i të dërguarve të mëparshëm është i njëjtë me atë të një burri që ndërtoi një shtëpi, të cilën e përsosi dhe e zbukuroi. Njerëzit që e vizitonin thonin se nuk kemi parë ndërtesë më të bukur, pa përmendur vendin bosh të një tulle! Unë isha ajo tullë!".

Pra, shtëpia e madhe e Thirrjes së Besimit dhe vendi i merituar që ka në të secili i dërguar. Me fjalë të tjera, besimi në Zotin Një, është institucioni më i shenjtë në jetën e gjithësisë, që i mundëson kujtdo, që e ka një qëllim fisnik, të bashkëjetojë në paqe e harmoni, pa bërë asnjëri rolin e gjyqtarit as atë të paragjykuesit!

Nëse drejtuesit fetarë në botën e sotme, do ta kuptonin drejtë këtë hadith, (ne muslimanët të parët), do të shërbente si shembull për ndërtimin e një bote të re mbi baza respekti të ndërsjellët dhe bashkëjetese paqësore, duke respektuar secili kufijtë e njëritjetrit.

Të nderuar të pranishëm,

"Fjala "bashkëjetesë", do të thotë se ka dy ose më shumë grupe njerëzish, që dëshirojnë të jetojnë së bashku në paqe, pa grindje, zënka e konflikte".

Ndërkohë sot, "Bota e jonë, në dukje e pafund, është bërë shumë më e vogël dhe çdo gjë është shumë më afër. Pra, ne sot, mund t'i biem qark globit në disa orë, në vend të kohëve të gjata, si në të kaluarën. Planeti ynë është si një shtëpi e madhe me një familje të madhe, anëtarët e së cilës vazhdimisht ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Fatkeqësisht, padrejtësia, lakmia dhe agresioni kanë shkatërruar dhe prishur shtëpinë e njeriut dhe harmoninë në botë, kështu që nevoja emergjente për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin është bërë shumë më e nevojshme se më parë. Sot, popujt e Lindjes kanë shumë nevojë për teknologjinë dhe shkencën perëndimore. Në perëndim, evropianët dhe amerikanët kanë nevojë për resurset e Lindjes dhe trashëgiminë shpirtërore!".

Nga ana tjetër, ajeti kur'anor, që qëndron si kryefjalë e lirisë së përzgjedhjes dhe respektimit të diversitetit fetar në Islam, është pa dyshim i 99-ti i sures Junus, ku Zoti i gjithësisë i drejtohet të Dërguarit të Tij duke i thënë: "Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë, që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?".

Shumë prej jush keni dëgjuar a lexuar për Kartën e Medines, marrëveshjen e Resulullahut (a.s) me fiset jomuslimane, për të jetuar në harmoni e paqe me njëri-tjetrin. "Karta e Medines dhe pakti i nënshkruar me të krishterët e Nexhranit dhe rrethinat e tij, si marrëveshja e Omerit më vonë, u garantonin qytetarëve nga ithtarët e Librit një status të privilegjuar në shtetin islam. Profeti Muhammed (a.s) ua garantoi të drejtat e tyre duke i konsideruar se janë në besën e Zotit dhe të Muhammedit (a.s), të Dërguarit të Zotit...".

Aty theksohet dukshëm se: "myslimanët dhe hebrenjtë në Medine, në shtetin e Pofetit Muhammed (a.s), konsiderohen si një komb i vetëm: "Hebrenjtë e Benu Auf janë qytetarë të një kombi bashkë me muslimanët. Hebrenjtë kanë fenë e tyre, kurse myslimanët fenë e tyre...". Në këtë Kartë, ceket qartë theksimi që Islami i bën pranimit të diversitetit fetar...". Me fjalë të tjera: "Karta e Medines hodhi bazën e lirisë së besimit dhe zgjedhjes së fesë... Kështu, nuk i lejohet askujt t'i imponojë besimin ndokujt".

> **Kur'ani Famëlartë dhe tradita profetike, vendosën rregullat dhe bazat e bashkëjetesës së muslimanëve me jomuslimanët, rregulla që bazohen mbi një të drejtë të shenjtë që është e drejta e fisnikërisë njerëzore**

BASHKËJETESA NDËRFETARE DHE MUSLIMANËT

Bashkëjetesa ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve, gjatë 14 shekujve të kaluar e deri më sot, është një prej çështjeve me një rëndësi të veçantë në historinë e qytetërimeve, që ka njohur përshkallëzime dypolare dhe ka arritur kulme interesante, që ia vlen përherë të studiohen e të merren si shembuj për të sotmen.

Për muslimanët, kjo dukuri shoqërore është shumë e njohur, sepse buron nga Kur'ani Famëlartë, sikurse vetë Hz. Muhamed (a.s.) e praktikoi këtë bashkëjetesë në jetën e tij dhe urdhëroi pasuesit e tij ta praktikonin.

Muslimanët e parë, i ftuan jomuslimanët në bashkëjetesën e pastër të udhëzuar nga mësimet qiellore, e cila në krahët e shekujve të gjatë pati lëkundjet e veta, me rritje dhe ulje, për shkak të fanatizmit, vulgaritetit e mbi të gjitha nga injoranca dhe moskuptimi i fesë së pastër qiellore, ose nga komentimet e mangëta, ekstremizmi i verbër, egoizmat apo interesat e ndryshme.

Kur'ani Famëlartë dhe tradita profetike, vendosën rregullat dhe bazat e bashkëjetesës së muslimanëve me jomuslimanët, rregulla që bazohen mbi një të drejtë të shenjtë që është e drejta e fisnikërisë njerëzore. Në Kur'anin Famëlartë, Allahu (xh.sh) thotë: "Ne, vërtet i fisnikëruam pasardhësit e Ademit (njerëzit)".

Ai vërtetoi, gjithashtu, se njerëzit janë të barabartë për nga origjina tyre, duke thënë: "O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur".

Këtë shpirt bashkëjetese e gjejmë edhe në çertefikatën e madhe islame të të drejtave njerëzore, nga goja e vetë Profetit Muhammed (a.s.), disa muaj para se të ndërronte jetë, në Haxhin e lamtumirës në Meke, kur thoshte: "Me të vërtetë Zoti juaj është Një dhe babai juaj është një, të gjithë ju jeni të Ademit dhe Ademi është prej dheut. Më fisniku ndër ju tek All-llahu, është më i ruajturi. Nuk ka epërsi një arab mbi një të huaj, as një i huaj mbi një arab, as një i kuq mbi një të bardhë dhe as një i bardhë mbi një të kuq, vetëm se me devotshmëri. A e kreva misionin? O Zot dëshmo! Të pranishmit të lajmërojnë ata që munguan".

"Rregulli bazë në çështjen e të drejtave të jomuslimanëve në shoqërinë islame është: "Kanë të drejta ato që kemi, kanë detyrime ato që kemi" , që si duket mbështetet nga thënia e Hz. Aliut (r.a): "Ata e kanë paguar taksën e tyre, që gjaku i tyre të jetë si yni (pra, garancia e jetës) dhe pasuritë e tyre si pasuritë tona!".

Dhe, bazuar mbi këtë, garancitë e shoqërisë islame ndaj jomuslimanëve, mund të ndahen në tre pjesë:

1. Mbrojtja nga agresioni i jashtëm. Ndër të tjera, këtu përmendet qëndrimi i Shejkhul-Islamit Ibn Tejmije, kur tatarët e pushtuan Damaskun, mbreti i tyre dëshiroi të lironte vetëm robët muslimanë, por Ibn Tejmije e kundërshtoi këtë me të madhe, duke kërkuar lirimin e krejt robëve, përfshi jomuslimanët... Madje, ai ia obligoi muslimanëve vijimin e luftës deri në lirimin e krejt të burgosurve. Kur mbreti tatar e pa vendosmërinë e muslimanëve, urdhëroi lirimin e krejt të burgosurve.

> **Sa herë flitet për bashkëjetesën ndërfetare, ne si muslimanë ndjehemi krenarë dhe shumë pozitivë, në raport me historinë, të sotmen dhe të ardhmen, pasi themelet e kësaj bashkëjetese ndërtohen mbi argumente të qarta kur'anore, hadithe të sakta dhe veprime konkrete të Resulull-llahut (a.s)...**

2. Mbrojtja e brendshme.

a) Mbrojtja e gjakut. Dëshmohet se përherë, Hz. Omeri (r.a), në pozitën e të parit të muslimanëve dhe drejtues i shtetit të tyre, përherë interesohej për gjendjen e jomuslimanëve në shtetin e tij, sikurse pyeste për ta krejt të deleguarit e tij nga zonat e largëta. Ata ia kthenin: "Nuk dijmë gjë tjetër, pos besnikërisë!"

Në historinë tonë islame është regjistruar edhe qëndrimi i Imam Euzaiut (v.157 h./774 g.), që doli në fytyrë të guvernatorit abasit Salih bin Ali, kur dëboi ca të krishterë nga zona e Malit të Libanit. Ai iu drejtua atij me një letër, ku ndër të tjera i shkruan: "... Porositë më të merituesshme për t'u ruajtur janë ato të Resulullahut (a.s), i cili ka thënë: "Ai që i bën padrejtësi një njeriu në besë, ose e ngarkon atë mbi mundësinë e tij, unë do të jem kundërshtar i tij (në ditën e gjykimit)".

b) Mbrojta e nderit dhe dinjitetit. Tek dijetarët e medhhebit tonë hanefi, ka një rregull që thotë: "Duhet të ndalet dëmtimi i dhimmiut, sikurse është haram të përflitet (gibeti), njësoj si muslimani".

c) Mbrojtja e pasurisë.

d) Siguracioni nga Bejtul-Mal (fondet publike). Për këtë ka shumë shembuj, po mjaftohem me veprimin e Resulullahut (a.s), kur ia dorëzoi Ebu Sufjanit, asokohe prijës jomusliman në Mekë, një sasi të madhe prej sadekasë, për t'ia shpërndarë të varfërve mushrikë, në kohë skamjeje... Sikurse është shkruar, se: "Ndihma e dhimiut nga Bejtul-Mali (Arka e Shtetit) i muslimanëve, në rast paaftësie të tij për punë, është një çështje konsensuale në ymmetin islam".

3. Mbrojtja e lirive të përgjithshme.

Këtu përfshihet:

a) liria e besimit, si në marrëveshjen e Resulullahut (a.s) me banorët e Nexhranit: "...Nuk ndryshohet asnjë ipeshkëv nga ipeshkëvia e tij, asnjë murg nga murgëria e tij, asnjë prift nga veprimtaria e tij, as nuk përçmohet". (Këtu, ka shumë shembuj konkretë nga historia, nuk do të zgjatem për efekt të kohës).

b) Liria e mendimit dhe e arsimimit. "Në kohën e Harun Reshidit të famshëm, krejt shkollat e Bagdadit u vendosën në menaxhim të Hanna Mensijes, i njohur, si: Gjon Masavejhi".

c) Liria e komunikacionit. d) Liria e punës, fitimit dhe e angazhimit me detyra shtetërore. e) Liria e aktiviteteve sociale, si festa, marshime etj.

E, ndoshta, ndër dëshmitë më të spikatura të bashkëjetesës në mesin tonë, është dëshmia e vitit 319 h, në "El-Kamil fit-Tarikh", ku përmendet se në atë vit, në Tikrit, në veri të Irakut, ndodhi një përmbytje e madhe nga shiu me rrebesh, ku u mbytën shumë njerëz dhe, me këtë rast, muslimanë dhe të krishterë u varrosën së bashku, pa u dalluar nga njëri-tjetri. ...".

Të dashurit e mi,

Sa herë flitet për bashkëjetesën ndërfetare, ne si muslimanë ndjehemi krenarë dhe shumë pozitivë, në raport me historinë, të sotmen dhe të ardhmen, pasi themelet e kësaj bashkëjetese ndërtohen mbi argumente të qarta kur'anore, hadithe të sakta dhe veprime konkrete të Resulull-llahut (a.s), sahabëve dhe pasuesve të tyre ndër shekuj, raporte të sinqerta të ngritura nga krejt muslimanët ndër shekuj.

Prandaj, organizime të tilla, meritojnë falënderim dhe mirënjohje të madhe, pasi bëhen shkak që ne mos të harrojmë asnjëherë tabanin tonë, shembullin dhe shpirtin e madh të mëshirës, respektit dhe vlerësimit të drejtave legjitime të tjerëve me ne!

All-llahu ju dashtë e ju mëshiroftë!

(Pjesë nga referati i mbajtur
në tribunën fetare me temë:
"Toleranca dhe bashkëjetesa në Islam",
organizuar nga Bashkësia Islame
në Regensdorf, Zvicër, më 25.3.2017)

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, ME RASTIN E MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1443/2022

Të dashur dhe të shtrenjtë motra dhe vëllezër besimtarë!

Muaji i madhërueshëm i Ramazanit tashmë po afron dhe kanë ngelur orët e fundit për të pritur hënën e re të këtij muaji të begatë. Të gjithë ne duhet të dijmë në krye të herës se Zoti i gjithësisë, Allahu (xh.sh) na ka ftuar në Kuranin Famëlartë duke thënë: "O ju të cilët keni besuar, ju është bërë obligim agjërimi, siç ishte obligim dhe për popujt e mëparshëm në mënyrë që ju të mbërrini në gradat e përkushtimit."[1]

Duhet të kuptojmë se Zoti i gjithësisë na fton duke na trajtuar si besimtarë, na merr me të mirë dhe na drejtohet me dashurinë e Tij (xh.sh) të pakufishme për të na falë bekime, mëshirë dhe për të na treguar që na do shumë dhe agjërimin e këtij muaji të begatë të Ramazanit e ka bërë rrugë që na shpie drejt mirësive, bekimeve dhe mëshirës së Tij (xh.sh).

Pejgamberi jonë (a.s) urdhëron dhe thotë: "Çdo vepër e birit të Ademit (a.s) është e tija, do të shpërblehet për atë, përveç agjërimit." Allahu thotë: "Ai është i Imi dhe Unë e jap shpërblimin për të!"

Subhanallah po të ndalemi pak tek ky hadith, do të kuptojmë fare mirë se Zoti i gjithësisë e ka veçuar agjërimin e Ramazanit nga të gjitha adhurimet e tjera, të cilat patjetër që Allahu (xh.sh) e jep shpërblimin për to, mirëpo agjërimin e Ramazanit e ka veçuar ndaj çdo adhurimi duke thënë: "Ai është i Imi dhe Unë e jap shpërblimin për të!"

Prandaj, të dashur besimtarë, duhet që gjithsecili prej nesh me zemër të përmalluar dhe me një vullnet të fortë të drejtohet me shpirt nga dyert e agjërimit për të përfituar maksimalisht nga kjo kohë e bekuar që po na vjen për ta ndryshuar jetën, për ta ndryshuar mënyrën e komunikimit me Zotin tonë, për ta ndryshuar mënyrën e komunikimit me njëri-tjetrin, për të përmirësuar marrëdhëniet me njëri-tjetrin, për ta bërë jetën tonë jetën e të devotshëmve të cilëve Allahu (xh.sh) i ka premtuar xhenetet, i ka premtuar vendet më të mira dhe më të begata në jetën e përtejme.

Transmetohet nga Imam Ebu Hanife (r.a) hadithi i Pejgamberit (a.s) se: "Çdo njeri besimtar, i cili uritet një ditë të vetme, duke u larguar nga haramet dhe duke mos ngrënë pasurinë e muslimanëve në mënyrën e gabuar, atij Allahu (xh.sh) do t'ia mundësojë të ushqehet nga frutat e xhenetit".

Ne po uritemi dhe po etemi me dëshirën dhe vullnetin tonë për të mirën tonë për hir të Allahut (xh.sh), jo një ditë, por 30 ditë! Po përpiqemi të largohemi nga ndalesat dhe të mos prekim pasurinë e muslimanëve dhe të ruhemi nga çdo ligësi dhe nga çdo gjë që Allahu nuk e pëlqen dhe të shpresojmë mirësinë dhe bekimet e Allahut (xh.sh) në këtë botë dhe në jetën e përtejme.

Duhet që gjithsecili prej nesh me zemër të përmalluar dhe me një vullnet të fortë të drejtohet me shpirt nga dyert e agjërimit për të përfituar maksimalisht nga kjo kohë e bekuar që po na vjen për ta ndryshuar jetën, për ta ndryshuar mënyrën e komunikimit me Zotin tonë, për ta ndryshuar mënyrën e komunikimit me njëri-tjetrin...

Të dashurit e mi, muaji i madhërueshëm i Ramazanit është muaji i 9-të në kalendarin hënor. Muaji i madhërueshëm i Ramazanit është ai, në të cilin u dërgua Hz. Muhamedi (a.s), i dashuri i zemrave tona, i cili u veçua prej njerëzve në atë shpellë të bekuar të Hirasë dhe, në një natë prej netëve të këtij muaji të begatë të Ramazanit, një krijesë e çuditshme, një zë që nuk e kishte dëgjuar më parë dhe një mesazh dhe mision që nuk kishte dëgjuar për të më parë iu shfaq dhe e tërhoqi për t'i dëshmuar Zotërisë së tij (a.s) dhe gjithësisë, se ky njeri i madh, Hz. Muhamedi (a.s) po shpallej në ato momente mëshirë për të gjithë botrat, me një fjalëkalim të shenjtë: "Lexo me emrin e Zotit tënd i cili krijoi çdo gjë."!

Xhebril Emini zbriti nga lartësitë e qiejve me një mesazh të qartë nga Zoti i gjithësisë për Hz. Pejgamberin (a.s) dhe për krejt njerëzinë: lexoni në emrin e Zotit tuaj, hapni zemrat Zotit tuaj, kthehuni nga Zoti juaj, mos e lini pas krahëve besimin dhe mos u hutoni në zigzaget e jetës suaj! Lexo! Dhe nga ai moment, gjithësia mori një pamje tjetër, më nuranite dhe më afër Zotit, dhe kështu do të jetë deri në ditën e fundit!

Në këtë muaj të madhërueshëm të Ramazanit u shpall Kurani Famëlartë për të cilin Allahu (xh.sh) thotë: "Muaji i Ramazanit është ai në të cilin filloi të shpallej Kurani"[2]. A nuk është koha që gjithsecili prej nesh të mendojë dhe të përgatitet me zemër dhe me shpirt për të kuptuar se të gjithë ne kemi nevojë t'i qasemi dhe t'i kthehemi këtij Libri të mrekullueshëm për të cilin Allahu (xh.sh) zgjodhi muajin më të mirë, pejgamberin më të mirë dhe natën më të mirë e më të spikatur (që e bëri adhurimin e saj më të mirë se një jetë, më të mirë se një mijë muaj), për t'u kthyer e për t'iu qasur këtij Kurani Famëlartë për të kuptuar se Zoti i gjithësisë nuk ka lënë asgjë që i duhet jetës sonë dhe të përtejmes sonë, përveçse na e ka sqaruar dhe na e ka treguar! Për të kuptuar se Alllahu (xh.sh) ka përmbledhur në këtë Libër të begatë historitë e njerëzve më të mirë dhe më të përzgjedhur të historisë së njerëzimit për të na i bërë udhërrëfim!

Ka vendosur në këtë libër historitë dhe devijimin e njerëzve më të shthurur për të na thënë kujdes, mos u bëni sikur ata sepse Unë ju dua dhe për hatrin tuaj këtë Kuran e shenjtërova dhe i dhashë vulën e mburojës së përhershme dhe askush nuk mund ta cënojë dhe askush nuk mund ta prekë dhe se ky Libër është karta juaj e garancisë për një jetë plot begati dhe plot mirësi!

Të dashurit e mi, në këtë muaj të begatë hapen dyert e xheneteve. Në këtë muaj të begatë Allahu (xh.sh) mbyll dyert e xhehenemit. Në këtë muaj të begatë Allahu (xh.sh) lidh shejtanët që krejt besimtarët dhe krejt gjithësia të përfshihet nga mëshira dhe mirësia e Tij (xh.sh) e pakufishme dhe njerëzit të angazhohen me veten e tyre, për t'u lartësuar drejt Zotit të gjithësisë.

Të dashur të e zemrës, një muaj i begatë po na vjen dhe ne jemi të ftuar t'i dalin para dhe ta presim me zemra të përmalluara e t'i tregojmë Allahut (xh.sh) në këto ditë dhe net që po vijnë më të mirën e vetës sonë në marrëdhënie me Zotin, në marrëdhënie me njëri-tjetrin, në marrëdhënie me veten, në marrëdhënie me gjithësinë!

1. Kurani, El-Bekare: 183.

2. Kurani, El-Bekare: 185.

ME KURANIN NË RAMAZAN

Muaji i Ramazanit është edhe muaji i Kuranit, në të cilin lexojmë: "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)."[1]

Në suren Fatir, ajeti 29, lexojmë: "Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë".

Këto dy ajete, por edhe të tjerë, që na nxisin të përkushtohemi sa më shumë ndaj Librit të Allahut dhe Fjalës së Tij, janë një motiv më shumë në këtë Muaj që po vjen, për të na angazhuar drejt leximit dhe kuptimit, angazhimit dhe shijimit të udhëzimit hyjnor, për të cilin kemi nevojë dhe drejt të cilit, Zoti i gjithësisë udhëzoi Pejgamberin tonë (a.s) që të kapej fort pas tij, duke i garantuar se është në rrugën e drejtë: "Andaj, përmbaju fort asaj që të është shpallur ty, sepse ti, në të vërtetë, je në rrugën e drejtë. Pa dyshim që Kurani është përkujtesë për ty dhe popullin tënd; e ju do të pyeteni".[2]

Një person erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe e pyeti se cila prej veprave është më e dashura tek Allahu i Madhëruar? Ai ia ktheu, duke mësuar njëkohësisht edhe sahabët e tjerë që e pyetën me kureshtje, se vepra më e dashur tek Allahu është angazhimi me leximin e plotë të Kuranit: "Ai që e nis leximin nga fillimi i Kuranit dhe saherë e përfundon e rinis nga e para"[3], duke na nxitur drejt traditës së Hatmes Sherife, të cilën, Resulullahu (a.s) e bënte çdo Ramazan me Xhebrailin (a.s), sikurse na mësojnë librat e hadithit.[4]

Hz. Enesi (r.a) na tregon se Resulullahu (a.s) ka thënë: "Allahu ka njerëz të afërt në mesin e njerëzve" I thanë: Kush janë ata, o i Dërguar i Allahut? Tha: "Njerëzit e Kuranit, ata janë njerëzit më të afërt me Allahun dhe të dashurit e Tij!".[5]

Poashtu, në porositë e Pejgamberit tonë (a.s) lexojmë edhe këtë transmetim të mrekullueshëm: "Thotë Zoti i Madhëruar: Atë që e angazhon Kurani nga lutja ime, do t'i jap më mirë sesa i jap atyre që luten! Dhe, mirësia e Fjalës së Allahut mbi krejt fjalët e tjera, është si mirësia e Allahut ndaj krijesave të Tij!".[6]

Poashtu, Resulullahu (a.s) na mëson se: "Ai që lexon një shkronjë nga Libri i Allahut të Madhëruar, ai do të ketë një të mirë për të dhe e mira do të shumëzohet për dhjetë. Nuk them: Elif-Lam-Mim, është një shkronjë, porse: Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë!".[7]

Në librin e tij mbi jetën dhe personalitetin e Imam Ebu Hanifes, Hoxhë i jonë, H. Vehbi S. Gavoçi, ndër të tjera sjell edhe një transmetim të një bashkëkohësi të dijetarit të shquar, ku lexojmë se: "Hafs ibn Abdurrahman ka thënë: E kam shoqëruar Ebu Hanifen për tridhjetë vjet. Ai e bënte një hatme Kurani në tre ditë me netët e tyre, si dhe jepte sadeka për çdo ditë!".[8]

Falë Allahut, është bërë traditë e bukur që për çdo Ramazan, Myftinia Shkodër të organizojë mexhlisin e Hatmes Sherife, duke nisur nga dita e parë e Ramazanit e deri në ditën që i paraprin Natës së Kadrit. Që do të thotë se të gjithë e kemi një mundësi më tepër për të prezantuar leximin e Hatmes, duke përfituar shpërblimet e kësaj tradite profetike dhe ringjalljen e saj në vendin tonë, brez pas brezi.

E, nëse nuk e kemi mundësinë e prezantimit të vazhdueshëm, patjetër që duhet ta shfrytëzojmë këtë Muaj që po na vjen për ta lexuar e mësuar Kuranin, për të nxjerrë mësime dhe udhëzime prej sureve dhe mesazheve që ato përcjellin, si dhe të përkushtohemi që Kurani të jetë pjesë e pandarë e jetës sonë!

Në përfundim të këtij vështrimi të shpejtë rreth marrëdhënies sonë me Kuranin në Ramazan, dua të sjell në vëmendje hadithin e ndërmjetësimit, ku mësojmë se Resulullahu (a.s) na ka dhënë sihariq se: "Agjërimi dhe Kurani do të bëjnë shefat (do të ndërmjetësojnë) për robin në ditën e kijametit. Agjërimi do të thotë: O Zot! E ndalova nga ushqimi dhe epshet, prandaj fale për mua! Ndërsa Kurani do të thotë: E ndalova nga gjumi natën (namazi i teravisë, etj.), prandaj fale për mua! Thotë: Dhe i bëjnë shefat!".[9]

Ferzet Ndoja
Vaize e Myftinisë Shkodër
Shkodër, më 27 mars 2022

1. Kurani, El-Bekare: 185.
2. KURANI I madhërishëm, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, Tiranë, 2008, f. 525. Ez-Zuhruf: 43-44.
3. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga Ibn Abasi (r.a).
4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Abasi (r.a).
5. Transmetuar nga Nesaiu, Ibn Maxheh dhe Hakimi, nga Enes ibn Malik (r.a).
6. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga Ebu Said El-Khudri (r.a).
7. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga Ibn Mesudi (r.a).
8. Vehbi Sulejman Gavoçi, Ebu Hanifeten-Numan imamul-eimmetil-fukaha, botimi i 6-të, Damask, 1999, f. 83.
9. Transmetuar nga Ahmedi, Taberaniu, etj.



CILËSIA E ARSIMIT S'MUND TË KUSHTËZOHET THJESHT DHE VETËM NË NJË ORË MËSIMORE, PËRKUNDRAZI...

Evans Drishti

Në çdo event që realizoni është e natyrshme që të kërkoni një mbështetje prej një grupi nxënësish të cilët:

Janë të kuptueshëm

Dinë të gjykojnë dhe të arsyetojnë për punën apo eventin me të cilin merreni.

Sillen të papërtueshëm dhe tregohen të shkathët në organizimin e një veprimtarie

Arrijnë të japin mendime dhe ide të qarta në përpilimin e një organizimi.

Lexojnë, jo vetëm tekstet shkollore, por padyshim edhe libra të gjinive të larmishme

Tregohen të mprehtë në vënien dhe realizimin e objektivave

Shfaqen dhe janë të sigurt në atë që kërkojnë

Rezultati i punës së tyre është përherë pozitiv

Janë produktivë

Aspirojnë në kërkim të risive ...

Në fakt, këtu nuk është fjala të kërkoni apo të formoni vetëm të ashtuquajturin "Grupi artistik i shkollës", përkundrazi është dhe duhet të jetë ai grup nxënësish, të cilët kanë aftësitë e duhura për realizimin suksesshëm të një eventi të caktuar, event ky që jo domosdoshmërisht është një program artistik.

Ju ndodh të organizoni:

Një seminar shkencor

Në këtë rast kërkoni të formoni një grup nxënësish që kanë prirje të qartë dhe të dukshme në lidhje me fushën përkatëse të shkencave natyrore, ekzakte apo sociale ...

Një ekspozitë

Në këtë rast kërkoni të mblidhni pranë vetes nxënës që kanë prirje për pikturën apo edhe për formimin dhe strukturimin e një ekspozite të larmishme, jo thjesht në pikturë.

Një konkurs

Në këtë rast përpiqeni të keni në grup nxënësish që tregojnë inteligjencë të shpejtë dhe mprehtësi në konkludimin e dijeve dhe informacioneve qofshin ato shkencore qofshin ato të kulturës në përgjithësi, nxënës të cilët karakterizohen nga një ambicie dhe shpirt shpërthyes në kornizat e një mprehtësie ideore të dukshme.

Një garë sportive

Në këtë rast, natyrshëm që përzgjidhni nxënësit më të shkathët me shpirt rrezatues në fushën e sportit, prej të cilëve pritshmëritë janë padyshim për një fitore të plotë.

Një projekt kurrikular

Në këtë rast vëmendja juaj përqendrohet në një shpërndarje të përgjegjësive për të gjitha natyrat e nxënësve, pavarësisht niveleve që shfaqin, ndërkohë ata që janë më të mprehtët dhe më të çlirët në diskutime gjejnë mundësinë dhe dalin më në pah.

Një tryezë të rrumbullakët

Në këtë rast gjeni mundësinë të trajtoni tematika të larmishme mes nxënësve duke nxjerrë në pah pikëpamje të secilit në formën e një diskutimi produktiv.

Në të gjitha rastet nxënësi është bashkëpunëtori ynë, me të cilin do të nisim rrugëtimin tonë për një arritje të suksesshme.

S'duhet harruar që:

E kemi të nevojshme "të guxojmë" në përzgjedhjen e një "ekipi" duke "këmbëngulur" dhe për rrjedhojë "duke provuar" gjithnjë e më shumë në ngritjen e cilësisë.

Ashtu sikurse një mësimdhënës e ka për detyrë të orientohet edhe në hapësira të ndryshme lëndore gjatë përgatitjes së një "ditari lëndor" të një ore të caktuar, ashtu i del si domosdoshmëri një mësuesi të bashkëveprojë edhe me të tjerë kolegë në përzgjedhjen dhe menaxhimin e suksesshëm të një organizimi.

Kështu:

Një bashkëbisedim mes dy – tri kolegësh solli një diskutim në lidhje me një temë që kishte të bënte me "Pemët gjenealogjike"

Në një bashkëbisedim të ngrohtë dhe profesional u gjykua për formimin e grupit të punës që do përbëhej nga nxënës të ciklit të gjimnazit.

U krijua "tryeza e rrumbullakët" mes mësimdhënësve të lëndëve të ndryshme si: Letërsi, Histori, Gjeografi, Art pamor, TIK dhe disa nxënësve të klasave të ndryshme të gjimnazit

U hartua plani i punës dhe u bë shpërndarja e detyrave përkatëse.

U krijuan lidhjet bashkëpunuese me komunitetin e prindërve.

U përcaktuan ditët përkatëse të organizimit të takimeve duke u treguar të përpiktë në çdo fazë të angazhimeve.

U përcaktuan materialet që do viheshin në ndihmesë në realizimin e organizimit.

U përcaktuan skemat përkatëse për grupimet në lidhje me temën në fjalë.

U hartuan tekstet shkencore me të dhënat e qarta historike, gjeografike e kulturore që do të referoheshin në organizimin në fjalë.

U përgatit ambienti i duhur i prezantimit të punimeve ekspozuese duke u ideuar në atë mënyrë që të reflektohej në çdo kënd.

U përgatit baza teknologjike si një mundësi e shëndetshme dhe produktive për sjelljen në terren të shumë elementeve "magjike".

Në çdo kohë bashkëpunimi mësimdhënës – nxënës u përshkua nga rigoroziteti dhe bashkëpunimi i frytshëm mbi bazën e vlerave njerëzore dhe profesionale.

Në realitetin e sotëm ndërgjegjësohemi se një nxënës produktiv në reflektimin e këtyre proceseve s'mund të jetë përherë vetëm një nxënës i notës (10) dhjetë, ashtu sikurse edhe e anasjellta, një nxënës i notës dhjetë s'mund të jetë përherë dhe në çdo rast produktiv edhe në realizimin e një projekti.

Cilësia e arsimit s'mund të kushtëzohet thjesht dhe vetëm nga një orë mësimore, përkundrazi është e detyrueshme të dilet përtej saj duke ofruar larmi dhe hapësirë të mjaftueshme, ku çdo nxënës të shpalosë dhuntitë dhe aftësitë personale për ti zhvilluar dhe evoluar në rrethana dhe kushte të ndryshme.

Në këtë drejtim, është e domosdoshme mbështetje që u duhet ofruar atyre mësimdhënëse dhe grupeve të nxënësve që përpiqen me mish e me shpirt të sjellin sa më shumë risi në proceset edukative, arsimore dhe reformuese duke zhvilluar në këtë mënyrë këndvështrime dhe pikëpamje të larmishme që ndihmojnë në ngritjen dhe zhvillimin e hovshëm të cilësisë së arsimit.

VIZITË VËLLAZËRORE E MIQVE TË SHTRENJTË NGA KUVAJTI

Paraditën e së shtunës, më 19 mars 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në qendrën kulturore të xhamisë së Kirasit, të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Kuvajtit në vendin tonë, z. Halid Esh-Shami, si dhe drejtorin për Ballkanin e "Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat", në Kuvajt, mikun e vjetër, z. Mahmud En-Nexhdi, që shoqërohej edhe nga i nderuari H. Samed Shehu, drejtor i Fondacionit "Mirënjohja" në Tiranë.

Të ndruarit, së bashku me Myftiun, iu drejtuan familjeve të jetimëve dhe fëmijëve, për të cilët kujdesen shoqatat në bashkëpunim me Myftininë Shkodër, me urime dhe këshilla në prag të Muajit Ramazan.

Myftiu, z. Nexhdi dhe ambasadori Shami, dhanë mesazhe me vlerë, në nxitje të ruajtjes së moralit të fesë, edukatës, ecjes përpara në shkollim dhe në kërkim të dijes dhe dëshmimit si qytetarë shembull në shoqërinë shqiptare dhe kudo.

Myftiu falënderoi kontributin e çmuar

të donatorëve kuvajtianë dhe theksoi se është një mirësi e madhe hapësira e gjerë e bashkëpunimit me vëllezërit e mirë nga Kuvajti të cilët përherë janë dëshmuar si përhapës të frymës së humanizmit të sinqertë e pa interes, kudo dhe me këdo në botë!

Myftiu vlerësoi kontributin e H. Samed Shehu, të nderuarit z. Mahmud En-Nexhdi dhe ambasadorit Esh-Shami në drejtim të afrimit të donatorit për qendrën islame në Kiras, aktivitetet e vazhdueshme kulturore dhe mbështetjen e jetimëve në veçanti.

AGJËRIMI I NDËRPRERË DHE AGJËRIMI ISLAM

Durim Kasemi,
Imam - xhamia e Parrucës

Agjërimi me ndërprerje është një teme që e dëgjojmë shpesh në këtë kohë. Është ndër trendët e fundit në fushën e dietologjisë, por: çfarë është agjërimi me ndërprerje? Përse shërben ai? Çfarë na duhet agjërimi me ndërprerje?

AGJËRIMI ME NDËRPRERJE DHE AGJËRIMI I RAMAZANIT.

Një ndër problemet tona - ne muslimanët - në kohët moderne është edhe fakti se ne zbulojmë aspekte të madhështisë së fesë sonë e disa prej urtësive të kapshme pas urdhëresave apo ndalesave nëpërmjet zbulimeve që bëjnë tjerët, atëherë e shikojmë dhe themi: Po këtë e kemi në Islam edhe ne! Edhe pse Kurani është i mbushur me thirrje për përdorimin e mendjes, për zbulimin e madhështisë së Allahut dhe logjikës së besimit e ligjeve të tij!

Tema për të cilën do të flas nuk bën përjashtim nga ky "rregull", dhe qëllimi është pikërisht ky, të kuptuarit e një pjesë krejt të vogël të urtësisë së agjërimit në dritën e zbulimeve shkencore bashkëkohore.

ÇFARË ËSHTË AGJËRIMI ME NDËRPRERJE?

Agjërimi me ndërprerje është një plan ngrënieje ku alternohen ngrënia dhe agjërimi në bazë të një kalendari të rregullt e të paracaktuar. Me fjalë të tjera, agjërimi me orare të caktuara, thënë ndryshe: syfyri dhe yftari. Allahu thotë: "Dhe hani e pini deri sa të dalloni vijën e bardhë të agimit nga vija e zezë, pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje...". - (Kurani, El-Bekare: 187)

Dr. Mark Mattson, neuroshkencëtar në Qendrën John Hopkins për studime mjekësore ka studiuar këtë lloj agjërimi për 25 vite[1], ai edhe na tregon se perse na duhet ky agjërim.

Ai thotë se kaloritë shtesë dhe mungesa e aktivitetit fizik, mund të jenë një rrezik më i madh për mbipeshën, diabetin e tipit 2, sëmundjet e zemrës, apo dhe sëmundje të tjera. Studimet shkencore tregojnë se agjërimi i ndërprerë mund të ndihmojë për të ndaluar këto trende.

SI PRAKTIKOHET AGJËRIMI I NDËRPRERË?

Ka disa mënyrë për të ndarë agjërimin, por të gjitha bazohen në përzgjedhjen e një kohe të rregullt për të ngrënë dhe agjëruar - lexo syfyr apo iftar, ndryshimi është se në të parin vendoset nga krijesa, ndërsa në të dytin nga Krijuesi që njeh çdo qelizë në trupin e njeriut dhe shumë më shumë përtej saj.

Christie Williams, dietologe në Qendrën John Hopkins për studime mjekësore tregon se ka disa mënyra për të praktikuar agjërimin me ndërprerje, ku ndër më të njohurat është ajo 8/16. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë: të hani gjatë periudhës 8 orësh dhe të agjëroni pjesën tjetër, pra 16 orët e mbetura. Me fjalën të tjera nga syfyri në iftar. Në këtë ramazan ne agjërojmë rreth 15 orë. Kjo lidhur me ndarjen e ditës.

Ndërsa lidhur me ditën e agjërimit gjatë javës ajo përmend metodën e njohur si dieta 5/2, e cila konsiston në ngrënien në pesë ditë të javës dhe agjërimin e dy ditëve. Thënë ndryshe agjërimin i ditës së hënë dhe të enjte. Aisheja (r.a) thoshte: "Pejgamberi (a.s) zgjidhte të agjëronte të hënën e të enjten". - (Tirmidhiu)

PËRFITIMET E AGJËRIMIT TË NDËRPRERË

Studimet kanë treguar se agjërimi i ndërprerë me periudha bën më tepër se djegia e kalorive.

Në një nga studimet e Dr. Mattson të publikuar New England Journal of Medicine[2], ai ka nxjerrë në pah një sërë të mirash shëndetësore, që vijnë nga kjo praktikë, ku përfshihet një jetë më të gjatë, mendje më të mprehtë dhe trup në formë.[3]

Shumë gjëra ndodhin gjatë agjërimit me ndërprerje, të cilat mund t'i mbrojnë organet nga sëmundjet kronike, siç janë diabeti i tipit 2, sëmundjet e zemrës, çrregullimet neurodegjenerative të lidhura me plakjen, madje edhe pezmatimet në sistemin e tretjes dhe shumë lloje kancerësh, shprehet Dr. Matttson.

Në një përmbledhje artikujsh të publikuar në mes viteve 1970-2019 (40 +) e të publikuara në një artikull të vetëm në revistën "Central African Journal of Public Health" me titull: "Ramadan Intermittent Fasting and Its Beneficial Effects of Health: A Review Article", autorët kanë arritur në përfundimin se:

Agjërimi i Ramazanit e ul masivisht rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare e diabetit, dhe kjo arrihet nëpërmjet uljes së peshës së trupit, kolesterolit total ldl, dhe duke ngritur vlerat e kolesterolit hdl.

Nga ana tjetër agjërimi i Ramazanit ka përfitime dhe efekte tek treguesit metabolik. Ai gjithashtu përmirëson efektivitetin e sistemit imunitar duke ulur citokinat[4] pro-inflamatore, dhe duke rritur proteinat komplemente[5]...

Agjërimi gjithashtu ul incidencen e diabetit duke ulur rezistencën e insulinës, duke rritur ndjeshmërinë e insulinës, përthithje e glukozës, etj...

Bazuar në rezultatet e këtij rishikimi të studimeve, përfitimet shëndetësore të agjërimit të Ramazanit mund të mbahen nëpërmjet agjërimit opsional pas muajit të ramazanit siç është edhe agjërimi i dy ditëve në javë, ditës së hënë dhe të enjte.[6]

Kur dëgjojmë këto fjalë nga studiues të fushës, mund të kuptojmë më mirë e më qartë urtësinë për nga aspekti fizik i agjërimit, përtej asaj shpirtërore dhe besimore, e mund të na vijë ndërmend hadithi për të cilin disa dijetarë kanë thënë se është me sened të dobët, e disa të tjerë hadith i dobët në të cilën thuhet: "Agjëroni që të jeni të shëndetshëm".

Gjithashtu dobitë shëndetësore të agjërimin nuk mund të kuptohen e nuk mund të konkretizohen pa marrë në konsideratë hadithin e saktë në të cilin Pejgamberi (a.s) thotë: "Gjëja më e keqe që njeriu mbushë, është barku i tij. Njeriut i mjafton të hajë disa kafshata që t'i mbajnë trupin gjallë e të fortë, e nëse nuk mundet të jetojë kështu, atëherë le të mbushë 1/3 me ushqim, 1/3 me pije, dhe 1/3 ta lërë për frymëmarrje". - (Tirmidhiu)

Gjithashtu na sjell në mendje fjalën e përkujtuesve të Zotit në Kuran: "O zoti ynë, këtë nuk e ke krijuar kot, pa qëllim e pa urtësi, i pa të meta je..." - (Kurani, Ali Imran: 191)

1.https://www.hopkinsmedicine.org/health/ëellness-and-prevention/intermittent-fasting-ëhat-is-it-and-hoë-does-it-ëork#:~:text=ëhat%20is%20intermittent%20fasting%3F,help%20your%20body%20burn%20fat.
https://www.health.harvard.edu/blog/intermittent-fasting-surprising-update-2018062914156

2. https://www.nejm.org/doi/full/10.1056/NEJMra1905136

3.https://www.sciencepublishinggroup.com/journal/paperinfo?journalid=326&doi=10.11648/j.cajph.20200605.17

4. Cytokinat ndikojnë në rritjen e të gjithave qelizave të gjakut si dhe qelizave të tjera të cilat ndihmojnë imunitetin e trupit dhe reagimin e tij ndaj inflamacioneve.

5. Proteinat komplemte janë pjesë e sistemit komplemet, pjesë e sistemit imunitar, që ka si funksion të rrisë aftësinë e antitrupave e qelizave fagocitare për të pastruar mikrobet dhe qelizat e dëmtuara nga organizmi, etj...

6.https://www.sciencepublishinggroup.com/journal/paperinfo?journalid=326&doi=10.11648/j.cajph.20200605.17

"BUQETË EMOCIONESH NË PRAG RAMAZANI", AKTIVITET ME MOTRAT BESIMTARE

Paraditën e të dielës, më 27 mars 2022, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare për motrat besimtare me titull: "Buqetë emocionesh në prag Ramazani".

Ky aktivitet i dha jehonë fillimit të Muajit të Madhëruar të Ramazanit, por njëkohësisht shënoi edhe mbylljen e ciklit të ligjëratave fetaro-psikologjike "Stacione reflektimi", të cilat janë mbajtura Live në Zoom nga teologia Zamira Bushati, si dhe ato të mbajtura në xhaminë e Parrucës dhe Tophanës nga teologet Ferzet Ndoja dhe Jetmira Plaku.

Aktiviteti i sotëm u kurorëzua me emocione të përzemërta nga të pranishmet, të cilat kishin mbushur plot sallën e konferencave tek Hotel Colosseu.

Programi i këtij aktiviteti ishte ndërthurur me ligjërata të mbajtura nga teologet e nderuara, si dhe lexim të Kuranit Famëlartë, ilahi të ndryshme dhe poezi, që u përcollën me mjeshtëri nga vajzat e reja.

Temat e kumtuara në këtë aktivitet ishin: "Me Kuranin në Ramazan" – teologia Ferzet Ndoja; "Ramazani, edukues i shpirtit" – teologia Jetmira Plaku, dhe "Si të arrijmë më të mirën në Ramazan" – teologia Zamira Bushati.

Këto ligjërata trokitën në çdo mendje e zemër, për të hapur dyert për mysafirin e begatë, muajin e shenjtë të Ramazanit.

Aktiviteti u ndoq edhe Live me anë të Zoom-it nga shumë gra dhe vajza të reja, nga vende të ndryshme të botës.

SIERRA LEONE
OSE REPUBLIKA E SIERRA LEONES

Sierra Leone, ose zyrtarisht 'Republika e Sierra Leones', është një vend që gjendet në Afrikën Perëndimore, në bregun e Atlantikut.

Ky vend kufizohet me Guinenë në veri dhe në lindje, me Liberinë në juglindje, kurse në perëndim laget nga ujërat e Oqeanit Atlantik.

Emrin "Sierra Leone" (Malet e Luanit) vendit ia ka vënë eksploruesi portugez i shekullit të 15-të, Pedro de Sintra, i cili hartoi portin e Freetown, dhe me këtë emër ai i referohej vargut të kodrave që rrethojnë portin.

Kryeqyteti i vendit është qyteti bregdetar **Freetown**, i cili konsiderohet edhe si një nga portet më të mëdha natyrore në botë.

Sierra Leone ka një sipërfaqe prej 71.740 km2 , dhe një popullsi prej 8.261.059 banorësh (Mars, 2022, sipas worldometers.info).

GJEOGRAFIA

Kënetat dhe pyjet mbulojnë pjesën më të madhe të brezit bregdetar të Sierra Leone-s, dhe shtrihen rreth 32 km në brendësi të tokës. Shumë nga kënetat janë tharë dhe pyjet janë prerë, për t'u zëvendësuar me arat e kultivuara me oriz. Këto këneta janë ngjitur me një fushë bregdetare, që shtrihet rreth 160 km në pjesën veriore të këtij vendi. Fusha bregdetare fillon të ngrihet gradualisht, për t'u ngjitur me pllajat dhe malet e shpërndara në verilindje të vendit, që mbulojnë më shumë se gjysmën e sipërfaqes së Sierra Leones.

Lartësia e maleve në këtë rajon i kalon 1800 m, veçanërisht në zonat që kufizohen me kufirin lindor me Guinenë. Në verilindje, malet Loma kurorëzohen nga mali Loma Mansa, me lartësi 1.948 metra mbi nivelin e detit, dhe malet Tingi, me lartësi 1.853 metra në majën Sankanbiriwa. Në këtë rajon ndodhen shumë këneta të ngushta të luginës së brendshme, që janë të lidhura me sistemet e lumenjve.

Sierra Leone karakterizohet nga prania e lumenjve të shumtë, të cilët burojnë nga malësitë e Futa Dxhallun të Guinesë, dhe që rrjedhin nga verilindja në jugperëndim, përgjatë territorit të vendit. Rrugët e tyre të mesme ndërpriten nga pragje të shpeshta, të cilat e kufizojnë lundrimin. Nivelet e lumenjve shfaqin luhatje të konsiderueshme sezonale.

KLIMA

Klima në Sierra Leone është tropikale, dhe karakterizohet nga alternimi i stinëve, me shi dhe të thata. Kushtet klimatike janë përgjithësisht të nxehta dhe të lagështa. Temperaturat mujore në zonat e ulëta bregdetare luhaten rreth një mesatareje prej 20 °C. Në brendësi ato variojnë mesatarisht

ndërmjet 25-27°C, me përjashtim të zonave të thella në verilindje, ku ekstremet e temperaturës janë më të mëdha: minimumet mesatare ditore atje bien në 10 °C, në Janar, dhe maksimalet mesatare ditore rriten në 30°C, në Mars.

Gjatë sezonit të shirave, nga maji deri në tetor, në vend dominojnë masat ajrore të lagështa, që vijnë nga Atlantiku. Qielli është i vranët, erërat janë nga jugperëndimi, rrezatimi i diellit është minimal, dhe shiu bie pothuajse çdo ditë, veçanërisht gjatë korrikut dhe gushtit. Gjatë sezonit të shirave temperaturat maksimale ditore bien në 6 °C.

Sezoni i thatë, nga nëntori deri në prill, karakterizohet nga 'harattani', një erë e nxehtë dhe e thatë që fryn nga Saharaja.

EKONOMIA

Sierra Leone është e pasur me burime natyrore, veçanërisht me diamant, ar, boksit dhe alumin. Megjithatë, shumica e banorëve të Sierra Leones merren me bujqësi, peshkim dhe me prerjen e drurëve. Të korrat e tyre më të rëndësishme janë orizi, misri, kafeja, kakaoja, xhenxhefili dhe drurët e rrallë. Prodhimi bujqësor në Sierra Leone karakterizohet nga një diversitet i madh, por toka e varfër, stina e thatë, si dhe varësia nga mjetet tradicionale të kultivimit, e bëjnë prodhimin bujqësor shumë të ulët.

Sierra Leone është ndër eksportuesit kryesorë në botë të fibrave të palmës 'piassava', që përdoren në prodhimin e fibrave, litarëve dhe furçave.

Orizi zë vendin kryesor në mesin e kulturave ushqimore. Sa i përket eksporteve të kulturave bujqësore, ato përfshijnë kafe, xhenxhefil, kakao dhe arrat kola.

Për sa i përket pasurisë shtazore, ajo përbëhet nga lopët, delet dhe dhitë.

Ujërat e Atlantikut në brigjet e Sierra Leone-s ofrojnë një sasi të madhe peshqish.

GJUHA

Anglishtja është gjuha zyrtare e përdorur në shkolla dhe në administratën qeveritare në Sierra Leone, kurse Krio është gjuha më e folur në vend, që flitet nga 97% e popullsisë.

FEJA

Sipas një vlerësimi të vitit 2020, të bërë nga Pew Research Center (Qendra Kërkimore Pew), 78.5% e popullsisë së Sierra Leone-s janë myslimanë, kryesisht sunitë... 20.4% janë të krishterë, kryesisht protestantë...dhe 1.1% i përkasin një feje tradicionale afrikane, ose besimeve të tjera.

Në Sierra Leone banojnë reth 18 grupe etnike, nga të cilët dy më të mëdhenjtë dhe më me ndikim janë etnitë Timni dhe Mende, dhe shumica e grupeve etnike të Sierra Leones janë me shumicë myslimane, përfshirë dy grupet më të mëdha etnike të vendit.

Shumica dërrmuese e muslimanëve të Sierra Leones i përmbahen traditës sunite të Islamit. Shumica e xhamive dhe shkollave islame, në të gjithë Sierra Leone-n, janë të bazuara në Islamin Sunit.

HISTORI

Gjetjet arkeologjike tregojnë se Sierra Leone ka qenë e banuar vazhdimisht, për të paktën që prej 2500 vjetësh, nga shoqëritë që migruan fillimisht nga pjesë të tjera të Afrikës. Pyjet e dendura tropikale tropikale të Sierra Leones dhe mjedisi kënetor, konsideroheshin të padepërtueshëm. Aty ekzistonte edhe miza cece, e cila mbartte një sëmundje fatale për kuajt dhe bagëtinë zebu që përdoreshin nga popullsia Mande. Ky mjedis i mbrojti banorët e tij nga pushtimi nga Mandet dhe nga perandoritë e tjera afrikane, dhe e kufizoi ndikimin e Perandorisë Mali në të.

Kryeqyteti, **Freetown**

Kontaktet e para evropiane brenda Sierra Leone-s kanë qenë gjatë shekullit të 15-të. Në 1462, eksploruesi portugez, Pedro de Sintra, hartoi atë që tani është porti i Freetown, duke e quajtur atë zonë 'Sierra Leone', që do të thotë: Malet e Luanit. Menjëherë pas ekspeditës së Sintra-s, tregtarët portugezë filluan të mbërrinin në port. Deri në vitin 1495, ata kishin ndërtuar një pikë tregtare të fortifikuar në bregdet. Holandezët dhe francezët gjithashtu filluan të mbërrinin aty dhe të zhvillonin tregtinë e tyre. Kombe të ndryshme evropiane filluan të përdorin Sierra Leone-n si një pikë tregtare për skllevërit e sjellë në bregdet nga tregtarët afrikanë, nga zonat e brendshme.

Ishulli Bunce, një ishull në lumin Sierra Leone, u përdor si një bazë për tregtarët evropianë të skllevërve, si një vend ku anijet e skllevërve ankoroheshin përpara se të lundronin përmes "Middle Passage", për në Amerikë. Deri në miratimin e Aktit të Tregtisë së Skllevërve (në vitin 1807, që parashikonte se asnjë skllav i ri nuk lejohej të importohej në Shtetet e Bashkuara), ishulli operohej nga kompania "Grant, Oswald & Co" me bazë në Londër, e cila e pushtoi atë në vitin 1748.

Pasi Parlamenti Britanik e bëri të jashtëligjshme tregtinë e skllevërve në vitin 1807, qeveria Britanike e mori nën pushtet koloninë (1 janar 1808) duke e përdorur si një bazë detare kundër tregtisë së skllevërve, dhe si një qendër në të cilën skllevërit, të kapur tranzit përtej Atlantikut, mund të silleshin dhe të liroheshin. Midis viteve 1807 dhe 1864, deri kur çështja e fundit e anijes me skllevër u gjykua në gjykatat e Freetown, marina britanike solli atje më shumë se 50.000 "të rikthyer", të njohur gjithashtu si "afrikanët e çliruar".

Të sjellë nga e gjithë Afrika Perëndimore, këta njerëz nuk kishin një gjuhë apo kulturë të përbashkët. Kështu që, qeveria koloniale prezantoi një politikë të qëllimshme për t'i kthyer ata në një komunitet homogjen të krishterë. Në vitin 1876, Shoqëria Misionare e Kishës Anglikane themeloi atje një institucion për të trajnuar mësues dhe misionarë, Kolegjin Fourah Bay, i cili ishte i lidhur me Universitetin e Durhamit në Angli. Ata hapën gjithashtu shkolla të mesme për djem dhe vajza.

Qeveria koloniale bëri traktate miqësie me sundimtarët fqinjë dhe gradualisht fitoi juridiksionin mbi vijën bregdetare. Në vitin 1896, vendi u shpall Protektorat Britanik. Për të mbledhur të ardhura për të paguar administratën e protektoratit, u vendos një taksë e re mbi banesën. Në vitin 1898, në vend shpërtheu një revoltë e drejtuar nga Bai Bureh (një prijës Sierra- Leonian, strateg ushtarak dhe teolog mysliman), por kjo revoltë u shtyp brenda një viti.

Pas Luftës së Dytë Botërore, si kudo në Afrikën Perëndimore, qeveria britanike u dorëzua para kërkesave nacionaliste në Sierra Leone. Institucionet demokratike u konstituuan

Banana Island, **Sierra Leone**

12

me ngut. Qeveria e re e zgjedhur, u drejtua nga Milton Margai, i Partisë Popullore të Sierra Leone-s (SLPP).

Më 27 Prill të vitit 1961, Sierra Leone u bë një shtet i pavarur, brenda Komonuelthit.

Në vitin 1971, Sierra Leone u bë një republikë, me Stevens si president ekzekutiv.

SI ERDHI ISLAMI NË SIERRA LEONE

Pothuajse të gjitha rrëfimet e transmetuara në librat e historisë moderne të Afrikës Perëndimore që trajtojnë temën se si erdhi Islami në Sierra Leone, janë të një mendimi se Islami, si një fe e lartë dhe e shenjtë, ishte e njohur dhe e dëgjuar nga sheikët e fiseve të Sierra Leones qysh në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, ndonëse në atë kohë Islami akoma nuk zbatohej atje. Është një gjë e njohur në Sierra Leone, qysh në kohë të hershme, se kush donte të largonte akuzën nga vetja, thoshte: "Unë jam musliman", që do të thotë se unë nuk bëj keq, si muslimani, i cili nuk bën keq.

Ky zakon vazhdon akoma edhe sot të jetë i përhapur në të gjitha qarqet islame, dhe jo vetëm. Shkaku se pse sheikët e Sierra Leone-s e konsideronin Islamin si kaq të shenjtë në atë kohë, ishte ardhje e atyre tregtarëve të mirë muslimanë nga Guinea, Senegali, Nigeria dhe Mauritania, në qytetet bregdetare të Sierra Leones, dhe kontakti i tyre me ta.

Islami, si teori, mbeti i shenjtë deri në betejat e famshme të Futa Dxhalun, të cilat, në shekullin e 18-të, e transferuan Islamin në kornizën e praktikimit.

Arsyeja e këtyre betejave është se njëzet e dy nga muslimanët e mëdhenj të fiseve Fula dhe Maninka, që jetonin në Guinea, bashkë me pasuesit e tyre, të udhëhequr nga Almami Suri, prishën daullen e një grupi pagan të Sierra Leone-s, të cilët kishin ndezur një grindje midis muslimanëve në rajonin e tyre, në Guinea. Kjo rezultoi në një përleshje që shpërtheu midis paganëve dhe muslimanëve të lartpërmendur, ku këta të fundit e konsideruan këtë luftë një xhihad të shenjtë, dhe në fund të saj ata korrën një fitore vendimtare, pasi i përzunë paganët përtej kufirit dhe i përndoqën deri në qytetet veriore të Sierra Leones, në Karina, Port Loko, etj.

Shumë muslimanë u vendosën në këto qytete dhe filluan të komunikojnë me qytetet dhe fshatrat fqinjë, për tregti, ndërkohë që kryenin ritet e tyre fetare të namazit, agjërimit dhe recitimit të Kuranit. Kjo bëri që disa nga paganët e Sierra Leone-s, me kalimin e kohës, të besonin në "fenë e burrit të zi" (u quajt kështu ngaqë ndjekësit e kësaj feje ishin zezakët që vinin nga Guinea). Dhe kjo ishte një arsye e pjesshme. Kurse arsyeja kryesore që ata filluan ta pranojnë Islamin është se Islami është feja e natyrës së pastër njerëzore. Kështu, një pjesë e paganëve filluan t'i ndiqnin muslimanët në namazin e tyre dhe në ritualet e tyre fetare, dhe lidhjet mes dy palëve filluan të forcohen.

Paganët e Sierra Leone-s filluan të krijonin një besim të fortë tek muslimanët, veçanërisht pasi muslimanët i ndihmuan Sierra Leoneasit, duke u qëndruar krah tyre kundër kolonialistëve portugezë dhe britanikë. Ky besim dhe kjo ndërthurje mes tyre, krijoi një hapje të re midis muslimanëve Guineas dhe popullit të Sierra Leone-s, gjë që rezultoi në dyndjen e mijëra muslimanëve të Guinesë, veçanërisht nga fisi Susu, për t'u vendosur në Sierra Leone.

Kështu, Islami filloi të përhapej në fshatrat dhe pyjet e Sierra Leone-s, si një "aromë e këndshme"... me anë të këtyre muslimanëve. Sheikët e fiseve të Sierra Leone-s, si ata të fiseve Mendi, Timni dhe Lumba, shpallën hyrjen e tyre në Islam dhe ftuan në të edhe të tjerët, pavarësisht nga tundimet e jashtëzakonshme që ofroheshin dhe që ende vazhdojnë të ofrohen nga institucionet misionare të krishtera për t'i tërhequr këta sheikë në fenë e tyre.

Myslimanët kanë luajtur një rol të artë dhe të rëndësishëm në historinë e Sierra Leone-s, pasi ata punuan shumë për pavarësinë e saj, përpjekje e cila buronte nga besimi i tyre i patundur në domosdoshmërinë e luftës në rrugën e Zotit, në mbrojtje të besimit, jetës, nderit dhe atdheut, duke kërkuar kështu kënaqësinë e Zotit. Dhe në fakt, ata kanë qenë një gjemb në sy të kolonializmit, që ua prishi gjumin atyre, derisa Sierra Leone fitoi pavarësinë e saj në vitin 1961, faleminderit Zotit!

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.marefa.org
https://www.britannica.com
https://www.ajurry.com
https://en.wikipedia.org
https://ar.wikipedia.org
https://worldometers.info

Xhamia **Gaddafi**, Freetown

PARAQITJA E VEPRAVE TEK ALLAHU (XH.SH) NË MUAJIN SHABAN

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Muaji Shaban llogaritet si muaji që bën përmbylljen vjetore të veprave të njeriut. Mes vlerave të këtij muajit përmendim faktin se në këtë muaj veprat e njeriut ngritën (paraqiten) tek Allahu (xh.sh). Usame ibn Zejd (r.a) transmeton e thotë: "I thashë Profetit: O i Dërguar i Allahut, nuk të kam parë të agjërosh ndonjë muaj tjetër (përveç Ramazanit) më shumë se sa muajin Shaban? Ai tha: Ai është një muaj mes Rexhebit dhe Ramazanit. Njerëzit tregohen të pakujdesshëm në këtë muaj, megjithëse ai është muaji në të cilin ngritën veprat tek Allahu (xh.sh). Prandaj unë kam dëshirë që veprat e mia të ngritën (paraqiten) tek Zoti ndërsa unë jam agjërueshëm."[1]

Kemi tre lloje të ngritjes dhe prezantimit të veprave tek Allahu (xh.sh)[2]:

Lloji i parë: Ngritja ditore. Në kohën e namazit të sabahut dhe të ikindisë bëhet ndërrimi ndërmjet melekëve të natës dhe të ditës. Melekët, të cilët ishin me ju natën, ngriten për tek Allahu. Edhe pse Ai e di të vërtetën më mirë se melekët, Ai i pyet për gjendjen tuaj: "Si i latë robërit e Mi?" Melekët thonë: "I kemi gjetur duke falur namaz, dhe i lamë duke falur namaz."[3]

Ibn Haxheri në Fet'hul Bari thotë: "Këto dy kohë janë shumë të rëndësishme. Sepse është transmetuar se risku shpërndahet në sabah dhe veprat ngriten tek Allahu (xh.sh) në fund të ditës. Kush gjendet gjatë kësaj kohe në adhurim do të begatohet në riskun dhe në veprën e tij."[4] Ed-Dahaku (Allahu e mëshiroftë) në fund të ditës qante dhe thoshte: "Nuk e di se çfarë më është ngritur nga veprat për tek Allahu."[5]

Lloji i dytë: Prezantimi javor. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Punët shfaqen (ekspozohen para Allahut) ditën e hënë dhe të enjte. Dua që punët e mia të shfaqen (para Allahut) duke qenë agjërueshëm".[6] Ebu Hurejra (r.a) tregon: "I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) agjëronte të hënën dhe të enjten. Dikush e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Ti agjëron të hënën dhe të enjten". Ai (a.s) i tha: "Ditën e hënë dhe të enjte, Allahu fal gjynahet e çdo muslimani, përveç dy personave që mbajnë mëri me njëri-tjetrin, (ata nuk i fal) derisa të pajtohen".[7] Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu i Lartësuar në natën e mesit të muajit Shaban ua falë gjynahet të gjitha krijesave të Tij, përveç atyre që i bëjnë shirk Allahut dhe ata që janë në armiqësi me njëri-tjetrin."[8]

Lloji i tretë: Ngritja vjetore. Në muajin Shaban ngritën veprat tek Allahu i Madhëruar duke u mbështetur në hadithin e Usame ibn Zejdit që e përmendëm më lartë. Është edhe një ngritje tjetër e veprave, ajo pas vdekjes. Ky është prezantimi i fundit i veprave.

Disa prej urtësive të agjërimit të shpeshtë të Pejgamberit (a.s) në muajin Shaban.

Dijetarët muslimanë kanë dhënë disa mendime rreth urtësisë së agjërimit të shpeshtë të Pejgamberit (a.s) në këtë muaj, ku prej tyre mund të përmendim:

1. Pejgamberi (a.s) agjëronte nga tre ditë në çdo muaj.[9] Kur nuk kishte mundësi që t'i agjëronte këto ditë për shkak të udhëtimit etj, i kompensonte në muajin Shaban.

2. Gratë e Pejgamberit (a.s), i kompensonin ditët e mbetura nga Ramazani i kaluar në muajin Shaban, edhe ai agjëronte me to. Këtë e vërteton edhe Aisheja (r.anha) e cila e vononte kompensimin e agjërimit të ditëve të mbetura nga Ramazani deri në Shaban, sepse ishte e angazhuar me Pejgamberin (a.s).[10]

3. Në këtë muaj ngritën veprat tek Allahu (xh.sh). Ky është mendimi më i saktë, duke u mbështetur në hadithin e Usame ibn Zejdit që e përmendëm pak më lartë.[11]

4. Agjërimi në muajin Shaban është parapërgatitje dhe ushtrim i besimtarit për të qenë i gatshëm për obligimin e madh, për njërën nga pesë shtyllat bazë të Islamit që është agjërimi i Ramazanit.

> **"Allahu i Lartësuar në natën e mesit të muajit Shaban ua falë gjynahet të gjitha krijesave të Tij, përveç atyre që i bëjnë shirk Allahut dhe ata që janë në armiqësi me njëri-tjetrin."**

Aisheja (r. anha) thotë: "Pejgamberi (a.s) agjëronte aq shumë sa njerëzit mendonim se ka vendosur të mos hante më, dhe nuk agjëronte një kohë aq të gjatë sa që njerëzit mendonin se nuk do të agjërojë më nafile. Nuk e kam parë Pejgamberin (a.s) të agjërojë një muaj të tërë përveç Ramazanit, ndërsa më shpesh e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban".[12]

5. Dijetarët muslimanë për të treguar vlerën e agjërimit në këtë muaj kanë thënë se: Veprat më të mira vullnetare janë ato të cilat kryhen sa më afër muajt të Ramazanit, qofshin ato pak para tij apo pas tij. E njëjta gjë vlen edhe me agjërimin e Ramazanit. Agjërimi më afër tij konsiderohet si sunetet e forta të namazit që falen para ose pas farzit, të cilat plotësojnë mangësitë dhe lëshimet që mund të kenë ndodhur në farz.

1. Transmetuar nga Nesaiu, hadith hasen.
2. Shih:Tehdhib Sunen Ebi Daud, Ibn Kajim, 3/199, Tarikul Hixhretejni, f. 75, Letaif El-Mearif, Ibn Rexheb, f. 126.
3. Transmetuar nga Buhariu.
4. Fet'hul Bari/ Sahih-i Buhari Şerhi, Ibn Haxher, 2/193.
5. Shih:Letaif El-Mearif, Ibn Rexheb, f. 127.
6. Transmetuar nga Tirmidhiu.
7. Transmetuar nga Muslimi.
8. Transmetuar nga Ibn Maxheh.
9. Muadhi thotë: "E pyeta Aishen (r.anha): "A i agjëronte Pejgamberi (a.s) tre ditë për çdo muaj"? Ajo mu përgjigj: "Po". Unë e pyeta: "Çfarë ditësh agjëronte"? Ajo m'u përgjigj: "Nuk i kushtonte asnjë rëndësi asnjë dite (agjëronte si të donte, si t'i vinte më mbarë)". (Muslimi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu).
10. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
11. Fet'hul Bari/ Sahih-i Buhari Şerhi, Ibn Haxher, 4/495-496.
12. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

LIGJËRATË NGA MYFTIU I SHKODRËS, IMAM MUHAMED B. SYTARI NË QENDRËN KULTURORE TË FSHATIT BARBULLUSH

Ditën e shtunë, më 5 mars 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari në kuadër të Muajve të Mirë, zhvilloi një ligjëratë fetare në qendrën e re kulturore të fshatit Barbullush, të përuruar para disa ditëve.

Në këtë takim merrnin pjesë besimtarë të zonës, të rinj si dhe imami i xhamisë Barbullush, H. Elvis Molla.

Myftiu gjatë ligjëratës së tij u ndal në një prej fjalëve profetike të Resulullahut, Muhammedit (a.s), të konsideruar si adresë e besimtarit në këtë jetë kalimtare: "Besimtari është një njeri miqësor, dhe i afrueshëm dhe nuk ka të mirë në një person që nuk është miqësor dhe i afrueshëm".

Ai tha se përmes këtyre fjalëve profetike duhet të kuptohet nga gjithsecili se besimtarët në thelb janë miqësor dhe të afrueshëm me të gjithë krijesat e Allahut (xh.sh), sepse të gjithë janë nevojtarë për Madhninë e Tij.

Në mesazhet e dobishme të Myftiut, ishte edhe fakti, se besimtarët janë njerëz të hapur, burim i të mirës, të cilën e mban me përkushtim, edukon fëmijët më të, si dhe e trashëgon brez pas brezi për t'u dëshmuar gjithsecili si të dashurit e Allahut (xh.sh), por edhe si përkrahës e përhapës të fesë së Tij dhe Dritës Hyjnore.

Në fund të takimit, të pranishmit bënë pyetje rreth tematikës dhe për të tjera tema aktuale me vlerë.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Me të vërtetë feja është e lehtë dhe çdo kush që ia vështirëson fenë vetes, ai e ka tepruar dhe nuk mund ta mbajë. Prandaj, mundohuni të bëni më të saktën e më të duhurën dhe përgëzoni...!"

(Transmetuar nga Buhariu).

AKTIVITET PËR 7 MARSIN, NDERIM PËR MËSUESIN!

Ditën e hënë, më 7 mars 2022, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën e Miqësisë "Shqipëri-Vende Arabe" organizoi një aktivitet kulturor me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

Krahas pjesëmarrjes së drejtuesve të Myftinisë dhe shoqatës, të pranishëm ishin veteranë të arsimit në Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë, të cilët me punën e tyre të palodhur dhe sakrifica edukuan dhe arsimuan breza të shumtë ndër vite.

Në fjalën e tij të hapjes, teologu Arben Halluni tha se: "Dita e Mësuesit është festë kombëtare jo vetëm për mësuesit e arsimtarët shqiptar, por edhe për nxënës e studentë, është një festë që festohet kudo, në çdo familje shqiptare.

Kjo është një traditë e bukur e krijuar tek ne, ku kujtojmë me respekt të thellë veprën e ndritur të mësuesve dhe patriotëve të shquar, që punuan me përkushtim dhe bënë sakrifica të mëdha, për zhvillimin e arsimit kombëtar".

Ndërsa, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tha se ai që do të mirën e kësaj bote le të mësojë nga urtësia e të urtëve, nga dija e mësuesve tanë të nderuar: "Në Kuranin Famëlartë, në librin e shenjtë që përfshin të gjitha librat e tjerë, lexojmë se Zoti i gjithësisë emrin më të bukur dhe cilësinë më të madhe të Madhërisë së Tij, Mëshirën, e ka lidhur me dijen, sepse thotë në Kuran citon: 'Mëshiruesi ia mësoi Librin (Kuranin)'. Pra, Zoti i gjithësisë e bekoi këtë rrugë për mbarë njerëzimin. Dhe kushdo që do më të mirën dhe suksesin e mbarësinë le të kthehet nga dija. Prandaj, edukatorët tanë na mësuan se, kush kërkon lartësimin në këtë botë le të zërë dije dhe kushdo që do të mirën e të përtejshmes përsëri le të mësojë!".

Ndërsa, z. Muammar Vuci, kryetar i Shoqatës së Miqësisë "Shqipëri-Vendet Arabe" në përshëndetjen tij theksoi se mësuesit janë njerëzit më shembullorë në të gjitha drejtimet dhe figura më e nderuar e kombit shqiptar si dhe shtresa që i ka dhënë zhvillim të madh dhe përparimit vendit.

Aktiviteti u pasurua edhe disa recitime të spikatura nga nxënëse të shkollës "Ndre Mjeda", që dhuruan emocione të veçanta.

Në fund, Myftinia Shkodër shpërndau për të pranishmit dhurata simbolike si shenjë respekti, vlerësimi dhe mirënjohjeje për misionin e tyre fisnik në edukimin e brezave të ndryshëm.

“RËNDËSIA E STUDIMIT TË TRASHËGIMISË POPULLORE NË KULTURËN ISLAME”

SEMINARI I 10-TË TRAJNUES ME IMAMËT E MYFTINISË SHKODËR

Ditën e shtunë, më 12 mars 2022, Myftinia Shkodër organizoi seminarin e 10-të trajnues me pjesëmarrjen e një grupi imamësh të xhamive të qytetit dhe fshatrave.

Merrnin pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, si dhe i ftuari special, si ligjëruea, Kryeimami i Bashkësisë Islame të Ulqinit, Ali ef. Bardhi.

Tema e këtij seminari ishte: “Rëndësia e studimit të trashëgimisë popullore në kulturën islame”, të mbajtur nga Mr. Ali Bardhi, i cili pasi falënderoi Myftininë e Shkodrës për ftesën dhe dhënien e kësaj mundësie për të ligjëruar rreth kësaj tematike mjaft intersante tha se: “Kurani Famëlartë dhe praktika profetike është burimi dhe frymëzimi për të hulumtuar dhe studiuar edhe për trashëgiminë shekullore, për të kaluarën e popujve të hershëm në aspekt të besimit, adhurimit, moralit, etj, si dhe për kulturën islame në përgjithësi.”

Kryeimami i Ulqinit u fokusua tek puna e tij disavjeçare për evidentimin, regjistrimin dhe studimin e varrezave muslimane dhe shqiptare në zonat shqiptare në Mal të Zi.

Vlen të theksohet se falë këtij përkushtimi të pashembullt, sot janë botuar tre vëllime të rëndësishme, ku është regjistruar historia dhe gjurma e shqiptarëve muslimanë ndër shekuj në këto zona.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, në fjalën e tij falënderoi Mr. Ali Bardhi për pjesëmarrjen si dhe për shpjegimin me vlerë të tematikës së këtij seminari.

Imam Sytari në kuadër të kësaj temë theksoi: “Është shumë e rëndësishme mbledhja e folklorit dhe trashëgimisë sonë islame në zonat shqiptare. Ne kemi një pasuri shumë të madhe, e cila duhet të jetë pjesë e libratekave tona. Ju ftoj të ktheheni tek ‘Fjalori i Orientalizmave’, i Tahir beg Dizdarit, ku në të do të gjejmë trashëgiminë tonë në të folurin e përditshëm.

Është shumë i rëndësishëm evidentimi i gjurmëve tona, të cilat duhen ruajtur dhe përhapur në masë si pjesë e trashëgimisë dhe identitetit tonë kombëtar.

Gjykoj se është obligim për bashkësitë tona islame që të vlerësojnë këtë trashëgimi dhe të punohet edhe më shumë në drejtim të regjistrimit të këtyre dështmive dhe gjurmëve shekullore, që për ne janë trashëgimia dhe historia islame në trojet tona shqiptare”.

Në fund, të këtij seminari pati pyetje dhe ndërhyrje nga imamët e pranishëm.

FALËNDERIM DHE MIRËNJOHJE!

Myftinia Shkodër shpreh falënderim dhe mirënjohje për të gjithë ata, të cilët përpiqen dhe kontribuojnë për të mbajtur pastër xhamitë e Allahut.

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë të gjithë me mirësitë dhe begatitë e Tij!

“MIRË SE VJEN RAMAZAN”, TRIBUNË FETARE NË PRAG TË MUAJIT TË RAMAZANIT

Pasditën e të martës, më 29 mars 2022, në sallën e ligjëratave të kompleksit pranë xhamisë Kiras, në vigjilje të muajit të begatë të Ramazanit u zhvillu tribuna fetare: “Mirë se vjen Ramazan”, me pjesëmarrjen e këshillit të Myftinisë, imamëve, myezinëve dhe këshillave të xhamive të Shkodrës.

Në fjalën e hapjes, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari shprehu kënaqësinë se atmosfera e begatë e Ramazanit ka filluar të ndihet në qytet dhe në fshatra, përmes përgatitjes së përgjithshme, pastrimeve, rregullimeve, propagandimit, etj.

Gjatë bisedës së tij, ndër të tjera, Myftiu dha edhe disa udhëzime dhe këshilla që kanë të bëjnë për organizimin e të gjitha riteve fetare ne xhami dhe përtej saj, zhvillimit të iftareve, derseve, Mukabeles/këndimit të plotë të Kuranit Famëlartë dhe të shumë veprimtarive të tjera të dobishme, të cilat duhen të përcillen tek xhemati.

Në fund, Myfiu uroj, për një muaji të begatë, plot dritë dhe shpresë si dhe Zoti (xh.sh) ta bëjë këtë muaj reflektim të besimit, të lidhje më tepër se kurrë me Krijuesin e gjithësisë përmes adhurimit dhe moralit të mirë me të gjithë krijesat e Zotit në tokë.

Në vijim, H. Durim Kasemi, imam i xhamisë Parrucë dhe H. Ruzhdi Plangaj, imam i xhamisë Kiras mbajtën nga një ligjëratë mbi rëndësinë, vlerat, dobitë shpirtërore, morale dhe fizike që ka agjërimi dhe Ramazani në përgjithësi.

Në fund të aktivitetit, u shpërndanë postera dhe kalendarët e Ramazanit.

MYFTIU PRITI DREJTUESIT E “UMRE MEDINA TRAVEL ALBANIA”

Paraditën e së mërkurës, më 30 mars 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror drejtuesit e Agjencisë UMTA, me qendër në Shkodër.

Gjatë takimit, Myftiu u interesua për zhvillimet e reja që lidhen me Umren e këtij viti dhe pritshmëritë për ditët e Ramazanit dhe më tej.

Ai falënderoi drejtuesit e kësaj agjencie të re dhe agjencive të tjera që ofrojnë shërbimet e dëshiruara për besimtarët e shumtë që iu rikthyen ritualeve të Umres, pas kohëve të vështira të bllokimit dhe masave të rrepta për shkak të pandemisë.

Drejtuesit e Agjencisë UMTA, teologët Ardit Hoxha, Ensar Avdi Ismalaj dhe Ervin Juku e informuan Myftiun edhe për përkushtimin e umrexhive shkodranë dhe përmallimin për vendet e shenjta dhe adhurimet në dy xhamitë kryesore të botës islame.

NË POSTRIBË ME: "BUQETË EMOCIONESH NË PRAG RAMAZANI"

Paraditen e të enjtes, më 31 mars 2022, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare, në ambientet e Restorant "Paradise", për motrat besimtare të zonës së Postribës me titull: "Buqetë emocionesh në prag Ramazani".

Ky aktivitet në prag të Muajit të Begatë të Ramazanit, përcolli njohuri dhe emocione tek besimtaret e shumta, të cilat ishin të pranishme në këtë aktivitet me vlera dhe me dobi.

Programi i këtij aktiviteti ishte ndërthurur me leximin nga Kurani Famëlartë, me ligjërata të mbajtura nga vaizet dhe teologet e Myftinisë së Shkodrës, znj. Ferzet Ndoja, znj. Jetmira Plaku dhe znj. Zamira Bushati, si dhe me ilahi të ndryshme e poezi, që u përcollën me mjeshtëri nga vajzat e reja.

MYFTIU FALËNDERON BAMIRËSINË E ARABISË SAUDITE PËR NDIHMAT E RAMAZANIT 1443/2022

Ditën e martë pasdite, më 29 mars 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një mesazh falënderimi dhe mirënjohjeje për bashkëpunimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së Mbretërisë Saudite, që tashmë është bërë traditë për disa vite rresht dhe që mundësojnë furnizimin me një sasi të konsiderueshme pakosh me ushqime për njerëzit në nevojë, që janë pjesë e projektit bamirës të Qendrës së Mbretit Selman për Ndihma dhe Bamirësi.

Myftiu Sytari theksoi se kjo ndihmë bujare dhe me vlerë është pjesë e shpirtit të madh të bamirësisë dhe humanizmit, me të cilin karakterizohen muslimanët në mbarë botën.

Janë gjithsej 340 pako me ushqime për familjet në nevojë, që është edhe mënyra më e mirë e pritjes së Muajit të begatë të Ramazanit, në të cilin jemi të ftuar të mëshirohemi e të solidarizohemi me njëri-tjetrin - tha ndër të tjera Imam Sytari.

MEJTEPI I IM... XHAMIA RRAGAM

Pak histori:

- Xhamia Rragam, ndodhet në Njësinë Administrative Gur i Zi, Shkodër.

- Përbëhet prej 30 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Osmani, Kasemi, Tahiri, Mani, Isufi, Zeneli, etj.

- Në vitin 1990 banorët e Rragamit morën xhaminë e tyre të vjetër, e cila në kohën e regjimit famëkeq komunist shërbeu si qendër kulturore. Rihapja e xhamisë së vjetër në këtë fshat përbën një ditë të shënuar e të paharruar për ta.

- Ndërsa, në vitin 2007 ndërtohet xhami e re me minare, ku nga ky vit deri më sot kanë shërbyer si imamë dhe mësues të fesë: Burhan Molla, Ibrahim Bilani, Dritan Cukali, Ozxhan Açikoz, Nimet Muça, Izmir Faja, Bujar Ymeri, Fadil Kraja dhe imami aktual Taksim Plori.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2022 është rreth 230 nxënës dhe nxënëse.



Takimi me nxënësit:

Në vazhdën e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, në fund të muajit shkurt 2022, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Rragam.

Fillimisht teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri të mësimeve të pastra fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit shpërndau bazë materiale (tekste mësimore, fletore, rezerva, etj) dhe më pas evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami, Taksim Plori.

Hatmeja e Kur'anit

në xhaminë e Parrucës

Myftinia Shkodër njofton të gjithë besimtarët muslimanë se këndimi i plotë i Kur'anit **(Hatmeja Sherife)** gjatë muajit të Ramazanit 1443/2022, zhillohet çdo ditë pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës.

Mirë se të vini në Mexhlisin e Fjalës së All-llahut!

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek